



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2635 / prot.
2

Elbasan, me 06.11.2023

VENDIM

Nr 36 datë 06.11.2023

"Për

**ngritjen e Komisionit "Ad Hoc", Për procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave:
Ulje tarife vjetore shkollimi për vitin akademik 2023-2024, të studentëve të Ciklit të dytë të
studimeve, për program të parë studimi.**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, lidhur me procesin e shqyrtimit e miratimit të rasteve për studentët e shkëlqyer, studentët me rezultate dhe studentët që plotësojnë kriteret të tjera për: ulje tarife vjetore shkollimi për vitin akademik 2023-2024, të studentëve të Ciklit të dytë të studimeve, për program të parë studimi, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- A. Ngritjen e Komisionit "Ad Hoc" për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve të shkëlqyer, studentët me rezultate (me notë mesatare të ponderuar 9.00-10.00) dhe kërkesave të studentëve me kriteret të tjera, për ulje tarife vjetore shkollimi për vitin akademik 2023-2024 për studentët e Ciklit të dytë për program të parë studimi me përbërje si më poshtë:
1. Filip Qosja – kryetar (menaxhimin e komisionit për realizimin e procedurave, përgatitjen e materialeve për Administratorin dhe relatimin e këtij materiali në Bordin e Administrimit)
 2. Eglantina Zaçe – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
 3. Romina Pitja – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
 4. Enea Qevani – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
 5. Laureta Bajrami – anëtare (Përgatitja e kërkesës për përpunim, nxjerrja e certifikatave familjare e-Albania, hartimi i inventarit të dosjes së studentit)
 6. Daniela Gërdani – anëtare (Përgatitja e kërkesës për përpunim, nxjerrja e certifikatave familjare e-Albania, hartimi i inventarit të dosjes së studentit)
 7. Rovena Zane – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistem, komunikimi me studentët për procedurat financiare)
 8. Arta Skënderi – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistemin e pagesave)

9. Blerina Seitaj – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistem, komunikimi me studentët për procedurat financiare)
 10. Armida Gjata – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistem, komunikimi me studentët për procedurat financiare)
 11. Rezart Gjata – anëtar (procedura e pritjes së kërkesave të studentëve dhe porokollimi i tyre)
 12. Etleva Sejdini – anëtare (procedura për llogaritjen e mesatareve për çdo program studimi FSHMT)
 13. Blerina Hyra – anëtare (procedura për llogaritjen e mesatareve për çdo program studimi FSHMT)
- B. Komisioni të realizojë pranimin e kërkesës së studentit, të kryejë verifikimin e nevojshëm në zbatim të akteve të mësipërme për këto procedura.
- C. Për studentët e shkëlqyer dhe studentët me rezultate, të merren të dhënat nga Fakultetet e UE-së dhe të bëhet përpunimi i tyre.
- D. Materiali i përgatitur nga komisioni të paraqitet nga Administratori i UE-së në Bordin e Administrimit për kërkesat e paraqitura në portokoll deri me datë 31.12.2023, sipas afateve të përcaktuara në VKM-t përkatëse.
- E. Ngarkohet Administratori dhe Komisioni i mësipërm me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT



ARDIAN DURMISHI